



Projekt

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORES,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 6674/3 Prot.

Lezhë, më 24 / 06 /2025

PROCESVERBAL Nr. 2
“PËR

DISKUTIMIN E PRIORITETEVE ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE
PËR THIRRJEN E VII-TË TË PROGRAMIT RELOAD2, FINANCUAR NGA
BASHKIA LEZHË”

Sot me datë **24/06/2025**, në orën 10:00, pranë Pallatit të Kulturës “Ded Ndue Lazri” **salla kati 3-të**, Bashkia Lezhë organizoi takimin me Organizatat e Shoqërisë Civile, në këtë takim i informuam për hapjen e Thirrjes së VI-të në kuadër të Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) e cila është e financuar nga fondet e Bashkisë Lezhë.

Njoftimin për datën e takimit si dhe prioritetet e propozuara ju dërguan me e-mail dhe publikimi në rrjetin social (facebook) https://www.facebook.com/photo/?fbid=1106612564855748&set=a.422421106608234&locale=sq_AL të Bashkisë Lezhë, gjitha organizatave që kanë qenë partnerë të thirrjeve të ReLOaD 2 në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu, njoftimi është publikuar dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë në linkun <https://lezha.gov.al/reload/>

Pas disa konsultimesh midis stafit të bashkisë me përfaqësues nga sektorë të ndryshëm, bazuar dhe në dokumentat strategjike afat mesëm dhe afat gjatë të Bashkisë Lezhë u përzgjedhën prioritetet të detajuara si më poshtë:

1. Shtimi i shanseve integruese dhe rritja e kujdesit social dhe shëndetësor për të moshurit.
2. Fuqizim ekonomik për viktimat e Dhunës në Familje;
3. Rigjallërimi i jetës sociale dhe kulturore në zonat rurale, nëpërmjet organizimit të festave lokale.
4. Jetëzimi i shkollave si qendra komunitare duke i pasuruar me aktivitete sportive në zonat urbane dhe rurale.
5. Përfshirja e teknologjisë dhe inovacionit në promovimin e Lezhës dhe resurseve të saj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

6. Promovimi dhe nxitja e ndërgjegjësimit ndaj çështjeve të sigurisë, duke përfshirë edhe sigurinë kibernetike.
7. Krijimi i programeve edukative për të rinjtë që promovojnë trasgëgiminë kulturore dhe artin.
8. Bashkëpunimi me shkollat lokale për të integruar aktivitetet kulturore në kurrikulën shkollore.
9. Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit të Lezhë mbi ndarjen dhe menaxhimin e mbetjeve në burim.

Takimi u hap nga **Znj. Vasilika Laska**, drejtor në Drejtorisë së Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës si dhe **22 pjesëmarrës** në takim. Përfaqësuesit pjesëmarrës bënë një prezantim të OSHC-ve që përfaqësojnë, ku më pas vijuan me leximin e prioriteteve.

Në takim diskutoj :

1. Kristiana Bashaj – përfaqësuese e shoqatës AlbGreen, e cila përgëzoi Bashkinë për nismat e tilla si dhe theksoj se prioritetet prekin të gjitha fushat por që propozoj që të bëhet një bashkim i Prioritetit 3 & 4, si dhe Prioritetit 8 & 4.
2. Gjergj Figuri - përfaqësues i shoqatës Unioni i Gazetarve, theksoj si të rëndësishëm Prioritetin 5.
3. Ndërsa përfaqësuesi i shoqatës Q.K.L.A propozoj që pjesë të prioriteteve të vendoset dhe informimi i të rinjvë në lidhje me programet e BE dhe mënyra se si të aplikohet dhe përthithen këto fonde.

Axhenda e takimit vijoj në një prezantim të shkurtër mbi zbatimin e Programin ReLOaD 2, informim mbi projektet e zbatuara në Thirrjet e Para Publike, si dhe prezantimi prioriteteve, afatet e përafërta të shpalljes së thirrjes së VII-të, shuma në dispozicion dhe kohëzgjatja e zbatimit të projekteve.

Në fund të gjithë përfaqësuesit u dakortësuan që thirrja e VII-të të hapet me 10 Prioritete duke qënë se janë gjithëpërfshirëse dhe ju jep mundësinë që çdo OSHC të ketë hapsira për të aplikuar.

Prioritetet përfundimtare pas konsultimit me OSHC-të janë si më poshtë vijon :

1. Shtimi i shanseve integruese dhe rritja e kujdesit social dhe shëndetësor për të moshurit.
2. Fuqizim ekonomik për viktimat e Dhunës në Familje;
3. Rigjallërimi i jetës sociale dhe kulturore në zonat rurale, nëpërmjet organizimit të festave lokale.
4. Jetëzimi i shkollave si qendra komunitare duke i pasuruar me aktivitete sportive në zonat urbane dhe rurale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

5. Përfshirja e teknologjisë dhe inovacionit në promovimin e Lezhës dhe resurseve të saj.
6. Promovimi dhe nxitja e ndërgjegjësimit ndaj çështjeve të sigurisë, duke përfshirë edhe sigurinë kibernetike.
7. Krijimi i programeve edukative për të rinjtë që promovojnë trasgëgiminë kulturore dhe artin.
8. Bashkëpunimi me shkollat lokale për të integruar aktivitetet kulturore në kurrikulën shkollore.
9. Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit të Lezhë mbi ndarjen dhe menaxhimin e mbetjeve në burim.
10. Rritja e kapaciteteve të të rinjve për pjesëmarrje aktive dhe përfitim nga programet që ofron Bashkimi Evropian.

Takimi u mbyll në orën 11:00.

DREJTORI
Vasilika LASKA